



---

## Asociacioni i Komunave të Kosovës

# RR E G U L L O R J A E PUNËS SË KOLEGJIUMIT PËR PLANIFIKIM HAPËSINOR TË KOMUNAVE TË KOSOVËS

## MAJ 2011

Me qëllim të realizimit të kërkesave të Kolegjiut për Planifikim Hapësinor të Komunave të Kosovës, të përkrahur nga **Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK)** me seli në Prishtinë, për rregullimin e punës së Kolegjiumeve, kolegjiut në mbledhjen e mbajtur më 18 maj 2011, miratoi:

# RR E G U L L O R E N E PUNËS SË KOLEGJIUMIT PËR PLANIFIKIM HAPËSINOR TË KOMUNAVE TË KOSOVËS

## I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

### Qëllimi

#### Neni 1

1.1. Me këtë rregullore përcaktohet organizimi dhe mënyra e punës së Kolegjiut të për Planifikim Hapësinor të Komunave të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kolegjiut);

1.2 Çështjet dhe kërkesat me rendësi nga fushëveprimi i Kolegjiut shqyrtohen në Kolegjiut. Kolegjiut jep mendime dhe propozime veçanërisht për:

- a) ndihmë profesionale që do t'i jepet Kuvendit dhe trupave ndihmëse të saja (komiteteve) kryetarit, organeve të administratës, etj lidhur me procesin e marrjes së vendimeve;
- b) ndihmë në zbatimin e ligjeve, urdhëresave, instruksioneve, vendimeve që kanë të bëjnë me punën e drejtorive komunale, Kolegjiumeve apo AKK-së, nëse nuk është paraparë ndryshe;
- c) ndihmën, apo dhënien e kontributit nëpër Grupe Punuese për hartim të ligjeve, akteve nënligjore apo kërkesave tjera varësisht prej nevojave të Kolegjiut, Komunës, institucioneve të Republikës së Kosovës apo të AKK-së;
- d) bashkëpunimin me Kolegjiutet tjera, Komunat, institucionet e Republikës së Kosovës, etj;
- e) bashkëpunimin me partneret vendor e ndërkombëtar të cilët përkrahin punën e Kolegjiumeve, Komunave, institucioneve të Republikës së Kosovës dhe AKK-së, etj.

## II. PËRBËRJA E KOLEGJIUMIT

#### Neni 2

2.1. Kolegjiutin e përbëjnë Drejtorët për Planifikim Hapësinor të Komunave të Kosovës, të caktuar me kontratë apo të emëruar nga Kryetari i Komunës;

- 2.2. Mandati i anëtarit të Kolegjiut do të varet nga kohëzgjatja e kontratës të tij si zyrtar ose nga Vendimi i Kryetarit të Komunës;
- 2.3. Kolegjiut ka kryesinë e punës prej 5 ose 7 anëtarëve;
- 2.4. Puna e Kolegjiut realizohet nëpërmjet bashkëpunimit, takimeve dhe mbledhjeve të cilat thirren dhe mbahen sipas planit të përgatitur nga AKK-ja dhe i miratuar nga ana e Kolegjiut;
- 2.5. Kolegjiut takohet sipas nevojave të Kolegjiut.
- 2.6. Takimet e kolegjiut janë të hapura.

### **III. PËRGATITJA DHE THIRRJA E MBLEDHJEVE TË KOLEGJIUT**

#### **Neni 3**

- 3.1. Kryesuesi i Kolegjiut apo zëvendës kryesuesi i fton anëtarët e kolegjiut, duke bërë të ditur temën e diskutimit së paku 5 (pesë) ditë para se të mbahet takimi;
- 3.2. Kolegjiut përmban kuorum nëse më shumë se gjysma e anëtarëve marrin pjesë në mbledhje;
- 3.3. Rekomandimet dalin me shumicë të votave.

### **IV. UDHËHEQJA E PUNËS, SJELLJA DHE VENDOSJA NË MBLEDHJE**

#### **Neni 4**

- 4.1. Mbledhjet e Kolegjiut sipas kësaj rregulloreje i udhëheq kryesuesi ose në mungesë të tij zëvendës kryesuesi apo njëri anëtar tjetër i kryesisë së Kolegjiut;
- 4.2. Para fillimit të mbledhjes, vërtetohet kuorumi i mjaftueshëm i anëtarëve, pastaj procedohet me rendin e ditës.

#### **Neni 5**

- 5.1. Kryesuesi i Kolegjiut, hap mbledhjen dhe njofton anëtarët se a pajtohen me rendin e ditës të propozuar. Pas miratimit të rendit të ditës, fillon mbledhja sipas pikave të rendit të ditës;
- 5.2. Pika për rendin e ditës mund të propozojnë edhe anëtarët e Kolegjiut nëse është e nevojshme.

#### **Neni 6**

Anëtarët e Kolegjiut mund të marrin pjesë në diskutim për të gjitha pikat e rendit të ditës, kërkojnë shpjegime, shtrojnë pyetje dhe kërkojnë përgjigje nga kryesuesi apo referuesi;

#### **Neni 7**

- 7.1. Shqyrtimi i pikave të rendit të ditës udhëhiqet veç e veç , sipas rregullit së pari në parim e pastaj në veçanti;
- 7.2. Mënyrën e udhëheqjes së shqyrtimit e propozon kryesuesi. Kryesuesi mund të propozojë që koha e shqyrtimit të zgjatë p.sh. 5 (pesë) minuta dhe replikë 1 (një) minutë;

## Neni 8

- 8.1. Anëtarët e Kolegjiut, nuk duhet ta ndërpresin fjalën e kryesuesit të mbledhjes ose të diskutuesve të tjerë, të përdorin fjalë ofenduese, të ndërmarrin sulme personale apo veprime ndaj ndonjë anëtari, të përhapin informacione që cenojnë jetën private të cilitdo anëtar, të sillen në mënyrë të padenjë ose të shkaktojnë rrëmujë në mjediset ku mbahet mbledhja e Kolegjiut.
- 8.2. Masat disiplinore që ndërmerren ndaj anëtarëve të Kolegjiut janë:
  - a) tërheqje e vëmendjes;
  - b) vërejtje;
  - c) marrja e fjalës
  - d) përjashtim nga punimet e mbledhjes.

## Neni 9

- 9.1. Diskutimi sipas pikave të veçanta të rendit të ditës zgjatë sipas rregullës deri sa të mbarojnë diskutimet e të gjithë të paraqiturve;
- 9.2. Kryesuesi mbyll diskutimin dhe propozon që të kalohet në përmbledhje të diskutimit;
- 9.3. Në bazë të propozimeve në material, mendimeve të paraqitura gjatë diskutimeve, kryesuesi formulon rezymetë apo rekomandimet dhe të njëjtat i paraqet për votim.

## Neni 10

- 10.1. Për propozimet vendoset me votim të hapur, i cili bëhet me ngritjen e dorës, ndërsa rezultatet e votimit vërtetohen me numërim;
- 10.2. Propozimet konsiderohen të aprovuara, nëse deklarohen me shumë se gjysma e anëtarëve të pranishëm.

## V. PROCESVERBALI

### Neni 11

- 11.1. Për punën e Kolegjiut, në mbledhje mbahet procesverbali;
- 11.2. Procesverbalin sipas rregullës e udhëheq anëtari të cilin e cakton kryetari në fillim të mbledhjes ose Koordinatori i Kolegjiut të AKK-së;
- 11.3. Procesverbali mbi punën e kolegjiut përmban të dhënat themelore, dhe atë: ditën dhe vendin e mbajtjes së mbledhjes, shenjën dhe numrin e mbledhjes, numrin e anëtarëve prezent të Kolegjiut, personat e tjerë që janë të pranishëm, emrin e kryesuesit dhe emrin e procesmbajtësit, rendin e përcaktuar të ditës, emrat e atyre që diskutojnë me përmbajtje të shkurtër të diskutimit dhe rezultatet e votimit sipas pikave të veçanta të rendit të ditës, mendimet e ndara të anëtarëve të Kolegjiut dhe çështjet tjera me rëndësi.

- 11.4. Në fund të çdo pike të rendit të ditës shënohet përfundimi sipas rendit të formulimit, ashtu si e paraqet kryesuesi;
- 11.5. Procesverbali mbahet në origjinal dhe nga një kopje e ekstraktit iu dërgohet pjesëmarrësve në mbledhje;
- 11.6. Procesverbali origjinal nënshkruhet nga kryesuesi dhe nga procesmbajtësi dhe i njëjti ruhet me materialin tjetër të mbledhjes dhe ruhet në arkiv, i cili pastaj publikohet në ueb faqen e AKK-së sipas nevojës;

## **Gjuhët e përdorura**

### **Neni 12**

Mbledhjet e Kolegjiut mbahen në gjuhën shqipe, duke siguruar përkthimin adekuat në gjuhë tjera, sipas nevojës.

## **VI. DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT**

### **Neni 13**

Çështjet që nuk janë rregulluar me këtë rregullore, rregullohen me propozime të veçanta të kolegjiut;

### **Neni 14**

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohet çfarëdo rregulle e vjetër.

### **Neni 15**

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit dhe zbatohet nga dita e miratimit të saj.

**KRYESUESI I KOLEGJIUMIT**

---